



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 381/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit KNPSH “P...”, me seli në me seli Komuna e Ferizajit NUI:, kundër debitorit Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.297/20 të datës 11.11.2020 të Përmbartuesit Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, jashtë seancës me datën 07.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.297/20, i datës 11.11.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.297/20, i datës 11.11.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, me të cilën është caktuar përmbartimi, sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit KNPSH “P...”, ndaj debitorit Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.297/20, të datës 11.11.2020 për detyrimin kryesor në shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), për shkak të përmbushjes së detyrimit kryesor.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat Sefer Sh. Arifi, me seli në Gjilan, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit KNPSH “P...”, ka caktuar urdhrin P.nr.297/20, të datës 11.11.2020, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës nr. P155 1/20, të datës 08.09.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës të lartcekur, të paguaj shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), në afat prej 7 ditësh si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore sipas UA MD-nr. 06/2014, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve në para e në qoftë se nuk mund të përmbushet borxhi nga mjetet në llogaritë bankare të debitorit, zbatimi i përmbarimit të realizohet edhe ndaj sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori me datën 18.11.2020, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton urdhrin për përmbarim, duke theksuar se i njëjti është lëshuar në kundërshtim me Ligjin nr.07/L-001 mbi ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2020, nenin 13 i cili citon që pagesa e paradhënies nuk është e detyrueshme. Më tutje ka shtuar se faturat janë lëshuar në kundërshtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e RKS-së, për vitin 2020 si dhe Ligjin nr.07/L-001, tabela 3.2 kodi 15435 faqe 14/134 dhe janë në kundërshtim me udhëzimet e bëra sipas emailit të datës 01.04.2020 si dhe çarkores informuesi të datës 31.03.2020 si dhe duke pasur parasysh se avansi nuk është parapara me nenin 29 “dokumentet e besueshme” të LPP-së, gjykatës i ka propozuar që të miratohet prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor.

Kreditori me datën 26.11.2020 ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor, i cili ndër të tjera ka deklaruar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit të theksuara në prapësim, dhe gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar ndërsa Urdhrin përmbarimor të lejuar nga përmbareuesi privat P.nr 297/20 të datës 11.11.2020 ta vërtetoj si të drejt dhe të ligjshme.

Përmbareuesi Privat Sefer Sh. Arifi përmes Njoftimit Zyrtar të datës 09.03.2021 e ka njoftuar gjykatën se debitori e ka përmbushur në tërësi obligimin ndaj kreditorit, por jo edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, duke i bashkëngjitur akt përcjellësin e datës 07.12.2020 për dorëzimin e lëndës në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe njoftimin/parashtresën nga kreditori për pagesën e borxhit të datës 04.03.2021.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, njoftimit zyrtar të datës 09.03.2021 të dërguar nga përmbaruesi privat, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përmbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi, P.nr.297/20 të datës 11.11.2020, është në shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent) është përmbushur në tërësi.

Sipas njoftimit zyrtar të datës 09.03.2021, të dorëzuar nga Përmbaruesi Privat Sefer Sh. Arifi, gjykata është njoftuar se debitori e ka përmbushur detyrimin kryesor, në shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), ndërsa është kërkuar që procedura të vazhdoj vetëm sa i përket shpenzimeve të procedurës, ku si provë për përmbushjen e detyrimit kryesor është bashkëngjitur njoftimi nga udhëheqësi i financave të kreditorit i cili ka njoftuar përmbaruesin se avansi për projektin Prizren – Prevallë në vlerë prej 996.580.17 € është inkasuar në llogarinë bankare të kompanisë përkatësisht kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga njoftimi zyrtar i përmbaruesit privat i datës 09.03.2021, konstatoi se debitori e ka përmbushur detyrimin për pagesën e borxhit, në shumën prej 996,580.17 € (nëntëqind e nëntë dhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë euro e shtatëmbëdhjetë cent), andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar në kuptim të nenit 71 par.1 nën par.1.2, ku përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij

aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor, e ka humbur efektin, sepse e njëjta është përmbushur nga debitori.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, në të cilën theksohet se “përveç tarifës së efikasitetit të përmbarimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbaruesit privat dhe kreditorit, tarifat tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbarimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Privat Sefer Sh. Arifi, P.nr.297/20 të datës 11.11.2020. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përmbarimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përmbarimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbarimor e la në fuqi, vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, 71 par.1, nën par. 1.2, nenit 73 par.1 dhe 3 të LPP-së nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.381/22, datë 07.09.2022

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,
nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,
në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.